




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA ADMINISTRATIVE E SHKALLËS SË PARË SHKODËR

Adresa: L. Qemal Stafa, Rr. Don Bosko, Tel&Fax +355 22 21 21 21 dhe +22 21 21 22

Nr. Rregj.Them.5
Dt. Rregj. 12.02.2014

Nr. Vendimi 5
Dt. Vendimi 30.03.2015



V E N D I M
“NE EMËR TË REPUBLIKËS”

Gjykata Administrative e Shkallës së parë Shkodër e përbërë nga:

Valbona DURRAJ – gjyqtare

Asistuar nga sekretare seance Albana PALAJ, sot me datë 30.03.2015, ora 13.00 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore çështjen administrative me nr.Rregj.Them. 05 date 12.02.2015 qe i perket:

KERKUESE:

Odetë Kerxhalliu, e bija e Adnan-it, e dtl. 06.12.1974, Indur në Gramsh dhe banuese në Shkodër, Lagjia “K.Përmetit”, Rruga “Oso Kuka”, apt. 1245, Shkodër,perfaqsuar në gjykim nga avokat Dritan Pirani,i autorizuar për përfaqsim me prokurë të posacme me nr. rep 532 dhe kol.233 dt.11.03.2015, me nr. license 6003, anëtar i dhomës së Avokatisë Shkodër,

Pale e interesuar:

Drejtoria Rajonale e Tatimeve Shkodër,perfaqsuar nga znj.Brikela Rroji e autorizuar për përfaqsim me autorizim nr.2242 prot. datë 19.03.2015

OBJEKTI:

Sqarim dhe interpretim I vendimit Nr. 2971 datë 05.11.2009, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, lënë në fuqi me vendimin Nr. 378 datë 24.06.2010, nga Gjykata e Apelit Shkodër, e përkatësisht në dispozitivin e këtij vendimi Pika 3, ku shprehimisht eshte vendosur... “Shpenzimet Gjyqësore I ngarkohen palës së paditur”, që në rastin konkret është në cilësinë e palës së interesuar.

BAZA LIGJORE:

Neni 314 të K.Pr.Civile.

Gjykata në përfundim të hetimit gjyqësor, pasi administroi provat shkresore të paraqitura, dhe pasi dëgjoi përfaqshuesin e pales paditese I cili kerkoi përfundimisht

pranimin e kerkese padis sipas objektit te saj, përfaqsesen e pales së tretë znj. Brikela Rroji e cila kërkoi rrëzimin e kërkesës si të pa mbështetur në ligjë dhe në prova, shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi:

VËREN se;

Kerkuesja Odeta Kerxhalliu, i eshte drejtuar Gjykates Administrative të Shkallës së Pare Shkodër me kerkese per; Sqarim dhe interpretim të vendimit Nr. 2971 date 05.11.2009, te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Shkoder, lene ne fuqi me vendimin Nr. 378 date 24.06.2010, nga Gjykata e Apelit Shkoder, e perkatesisht ne dispozitivin e ketij vendimi,

Pika 3, ku shprehimisht eshte vendosur ... "Shpenzimet Gjyqesore i ngarkohen pales se paditur Drejtoria Rajonale e Tatimeve Shkoder.

Gjykata e Rrethit Gjyqesor Nr. 2971 date 05.11.2009, te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Shkoder, lene ne fuqi me vendimin Nr. 378 date 24.06.2010, nga Gjykata e Apelit Shkoder, eshte vendosur :Pranimin e kerkese Padise.

- Anullimin e vendimit te Drejtorise Rajonale te Tatimeve Shkoder te shprehur nepermjet „Njoftim Vleresimi per detyrimet Tatimore“ Nr. 2595/55 Prot, date 17.04.2009, drejtuar paditeses Odeta Kerxhalliu persa i perket detyrimit, interesit dhe gjobes si dhe vendimit Nr. 2261 date 27.07.2009 te Drejtorise se Apelit Tatimor Tirane.

- Shpenzimet Gjyqesore i ngarkohen pales se paditur.

- Kunder ketij Vendimi mund te behet ankim ne Gjykatën e Apelit Shkoder brenda 15 diteve nga e nesermja e shpalljes.

Ne tabelen e shpenzimeve gjyqesore bashkangjitur vendimit eshte percaktuar ne zerin taksa e rregjistrimit 3000 leke dhe perfundimisht totali i shpenzimeve po i njejte.

Ne kete kerkese per sqarim dhe interpretim vendimi paditesi kerkon dhe :

Detyrimin e pales se paditur mbi te gjitha shpenzimet gjyqesore, e perkatesisht:

- 1- Pergatitja e Kerkeses Ankimore, drejtuar Drejtorise se Apelimit Tatimor date 09.05.2009, ne masen 15.000 Leke
- 2- Pergatitja e Kerkese padise, drejtuar Gjykates se Rrethit Gjyqesor Shkoder, ne masen prej 15.000 Leke.
- 3- Perfagesim me avokat ne Gjykatën e Shkalles se Pare, me pale ne masen 40.000 Leke si dhe rimbursim i detyrimit Tatimor te paguar ne masen 61.966 Leke.

Duke qene se ky vendim, akoma sot e kesaj dite nuk rezulton te jete ekzekutuar nga ana e pales se paditur, pale e interesuar në këtë rast, jemi perpara rastit te parashikuar nga neni 314/2.

Ne kuptim ne neni 314/1, jemi perpara rastit kur kjo pjese sipas objektit te kerkeses, duhet sqaruar persa i perket vleres se detyrimit nga ana e pales se paditur/debitore ndaj kerkueses, pasi ne keto kushte, ky vendim i Gjykates do te ishte tejet i veshtire te ekzekutohej, pasi ne veshtrimin tone le hapesire per keqinterpretim nga ana e pales debitore. Duke qene se sic permenda me siper, nga ana e Gjykates se Rrethit gjyqesor Shkoder, kerkese padia eshte pranuar plotesisht, i kerkojme Gjykates qe ne mbeshtetje te kerkeseve te neni 314/1 te K.Pr.Civile te beje sqarimin e Vendimit Nr. 2971 date 05.11.2009, te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Shkoder, lidhur me pjesen e dispozitivit, - Shpenzimet Gjyqesore i ngarkohen pales se paditur. (Drejtorisë Rajonale te Tatimeve Shkoder).

Gjykata Administrative e Shkalles se Pare Shkodër pasi degjoi parashtrimet e kerkueses ne kerkese ne prani te personit te trete Drejtorise Rajonale te Tatim Taksave Shkoder, terhoqi dosjen e themelit qe i perkasin vendimeve te sipercituara konstatoi se;

Gjykata ne piken 3 te dispozitivit eshte shprehur shpenzimet gjyqsore anes se paditur (DRT-shkoder) dhe se ka percaktuar masen 3000 leke total i shpenzimeve ne tabelen shpenzime - bashkangjitur vendimit.

Qe do te thote qe vendimi jo vetem eshte i qarte ne lidhje me kete pike por dhe nuk ka nevojte per interpretim sic dhe kerkuesja pretendon. Pretendimi i kerkueses nuk gjene mbeshtetje me akte provuese me faturat tatimore, te administruara ne dosje ne lidhje me shpenzimet, per kerkese padi, kerkese ankimore drejtuar Drejtorise se Apelimit Tatimore Tirane dhe mbrotjes me avokat, sic dhe ajo pretendon, per pasoje kerkimi per kete pretendim te pa provuar rrezohet.

Ne lidhje me kerkimin per rimbursimin e detyrimit tatimor te paguar ne masen 61.966 Leke, i cili eshte objekti i gjykimit te themelit per te cilat gjykatat jane shprehur me vendim, eshte i gabuar, pasi vendimi eshte i formes se prere dhe per pasoje eshte pjese e ekzekutimit te detyrueshem qe ana e paditur DRT-shkoder, duhet ta ekzekutoje dhe nuk mund te jete pjese e kerkeses per sqarim dhe interpretim vendimi.

Perfundimisht nga sa me siper arsyetuar gjykata vendosi rezimin e kerkeses si te pa mbeshtetur ne prova dhe ligj.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata, bazuar në nenin 40, 41, 42 të ligjit nr 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative"

VENDOSI

Rrezimin e kerkeses.

Shpenzimet gjyqsore sic jane bere.

Kundër vendimit lejohet ankim i vecantë brenda 5 ditëve nga e nesërmja e shpalljes në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë.

Shkoder me date 30.03.2015

SEKRETARE SEANCE
Albana PALAJ



GJYQTARE
Valbona Durraraj

VERTETOHET SE VENDIMI KA MARRË FORMË TË PRERË

SOT ME DATË. 15.04.2015

KANCELARE

BLERTA NURIA

